

Të kujdesemi së bashku për të rinjët dhe kështu të parandalojmë përhapjen e kronavirusit

Sipas rekomandimeve të qeverisë tubimet publike kufizohen deri në dhjetë persona dhe preferohet largimi nga qëndrimi i panevojshëm në vende publike. Që të mund ta ngadalësojmë përhapjen e koronavirusit, njerëzit duhet të ju largohen mundësishtë sa më shumë pjesëmarrjes në tubime shoqërore. Të bëhet kështu me qëllim që të mbrohen njerëzit që ju takojnë grupeve më të rrezikuara dhe që të mos mbingarkohet sistemi i perkujdesjes shëndetësore.

Edhe pse të rinjët duhet të mësohen të marrin vetë përgjegjësinë për veprimet e tyre, megjithatë përgjegjësia kryesore ndaj të rinjëve në moshë të mitur bie mbi prindërit e tyre. Policia dhe shtëpia për veprimtari me të rinjët ju bënë thirrje prindërve, që me të rinjët të bisedohet lidhur me këto çështje.

Fëmijët dhe të rinjët në përgjithësi lëvizin shumë, dhe e kalojnë kohën në grupe më të mëdha. Tani të gjitha lëvizjeve të tepërta, takimeve dhe qëndrimeve në vende publike duhet të ju largohen. Gjithashtu edhe parqet me lojra, parqet sportive dhe vendtubimet duhet të shmangen – duke vepruar kështu së paku edhe për muajin në vazhdim.

Në Finland tani është situata e jashtëzakonshme. Nëse dikush nuk i respekton urdhëresat dhe rekomandimet e zyrtarëve, si pasojë mundet që dikush të vijë në rrezik për jetë. Të gjithë duhet ta kenë parasyshë këtë. Poashtu edhe fëmijët dhe të rinjët.

Kontaktet shoqërore mund të mbahen edhe në mënyrë virtuale

Tani është e pëlqyeshme për të mbajtur kontaktet në mediumet sociale, duke dërguar ftësë për videotelefonata, praktikimin e lojrave dhe leximi i librave. Edhe pse takimet fizike janë kufizuar të rinjët janë të shkathët për të mbajur kontaktet mes veti në mënyra tjera!

Personeli i shtëpis së të rinjëve ndihmojnë përmes interneti

Personeli i shtëpis së të rinjëve është zhvendosur nga shtëpia e të rinjëve në internet dhe do të patrollojnë nëpër qytet që t'i takojnë të rinjët. Me të rinjët do të mbahet veprimtari digjitale në platforma të ndryshme. Personeli për punë me të rinjët do të kujdestarohet bie fjala në WhatsApp, Discord-chatin dhe në Instagram. Informata shtesë do të merrni në adresën nuortenvantaa.fi si dhe në kanalet e mdiumeve sociale për të Rinjët në Vantaa.

Së bashku mundemi me e parandalue përhapjen e koronavirusit – me bashkimin e forcave nga të gjitha shtëpitë në këto kohë të jashtëzakonshme!

Duke ju dëshiruar një fundëjave të qetë

Policia nga Itä-Uusimaa dhe personeli për shërbime ndaj të rinjëve në Vantaa